



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr 893 prot

Vlorë më 01/7 /2020

Vendim

Nr 14 datë 22.6.2020

PËR

**SHTESE NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT TË VITIT 2020,
MIRATUAR ME VKQ NR 14 DT.27.12.2019**

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për përgatitjen e shtesës së buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë të vitit 2020, mbështetur në

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41 ,neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40 .
- Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligjin nr. " për buxhetin e vitit 2020", neni 16.
- Ligjin nr. 137/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit European për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020.
- V.K.M. nr. 783 dt. 09.11.2016 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit European për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020"
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- "Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr.2. datë 20.01.2020 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020".
- Shkresës nr 130/1 datë 27/02/2020 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për miratim fondi (grant) Për Impiantin e Ujrave dhe shterasve të Landfillit Bajkaj

VENDOSI:

I.Të miratojë shtesë te Gërma A të ardhura gjithesej, të shtohet pika III. (Grant i Kushtëzuar) në 10.400.000 lekë

	Ishte	Bëhet
A. TE ARDHURA GJITHESEJT	135.154.746	145.554.746
1. Grant i Kushtëzuar	-	10.400.000

2.Të miratojë shtesë te gërma B, Shpenzime të shtohet pika 5 (Shpenzimet nga granti i kushtëzuar) Punime shtese të Impiantit të trajtimit të ujrave dhe shtresave të Landifillit Bajkaj)

Art 231 në vlere 10.400.000 lekë

si më poshtë

	Ishte	(në lekë) Behet
B. SHPENZIME GJITHËSEJ	135.154.746	145.554.746

1.Shpenzime nga Granti Kushtëzuar	-	10.400.000
Investime Art. (231)		

Punime shtese të Impiantit të trajtimit të ujrave dhe shtresave të Landifillit Bajkaj)

10. Ky vendim hyn në fuqi sipas *ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*.